

## Depozitë me Afat - Standarde (Një Vjeçare)

### Informacion rreth Bankës

#### Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rr" Ismail Qemali, Nr. 27,  
Kutia postare 8319  
1001 Tirane, Shqipëri  
Tel: +355 4 22 76 000; Fax +355 4 22 48 762  
Website: www.intesasanpaolobank.al

### Karakteristikat dhe rreziqet e Depozitës me Afat

#### Karakteristikat e Depozitës me Afat

Depozita me afat (TD) është një depozitë bankare me interes, me një datë të caktuar maturimi që vendoset nga Klienti në Bankë për një periudhë kohore fikse dhe të dakordësuar, e cila zakonisht mund të jetë tre mujore, gjashtë mujore, një vjeçare, dy vjeçare dhe tre vjeçare. Depozita me afat mund të hapet në LEK/EUR/USD dhe GBP. Në datën e maturimit depozita mund të rinovohet me normën e interesit që publikohet në Kushtet e Punës së Bankës në momentin e rinovimit. Rinovimi mund të jetë:

- Vetëm Principali, interesi kreditohet në llogarinë rrjedhëse të klientit
- Principal + Interes (minus tatimin në burim)

Nëse depozita nuk është e rinovueshme, në datën e maturimit principali dhe interesi (minus tatimin në burim) do të kreditohen në llogarinë rrjedhëse të klientit  
Klienti duhet të ketë një llogari rrjedhëse.

#### Tregu i synuar

Tregu i synuar për depozitat me afat janë të gjithë klientët që duan të kursejnë para për një periudhë afat shkurtër ose afat gjatë dhe në të njëjtën kohë të fitojnë interesa.

#### Dokumentet e nevojshme

Pasaportë/Kartë Identiteti  
Kontratat e Depozitave  
Kërkesa për Depozitë me Afat

#### Rreziqet e Depozitës me afat

1. Kompensimi i depozitave bazohet në nenin 33, paragrafi 1, pika a) e Ligjit nr. 53/2014, datë 22/05/2014 "Për sigurimin e depozitave", në bazë të të cilit ASD siguron dhe kompenson depozitat e çdo depozituesi në Bankë ose në degën e bankës së huaj deri në masën 100 përqind, por në çdo rast jo më shumë se Lek 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë), pavarësisht nga numri i depozitave dhe monedha e tyre, që janë depozituar në Bankë.

2. Llogaria rrjedhëse që lidhet me depozitën me afat është pa komision vetëm nëse përdoret ekskluzivisht për transaksionet e depozitës me afat dhe nuk lidhet me ndonjë produkt tjetër, në të kundërt do të aplikohet komisioni i mirëmbajtjes mujore sipas Kushteve të Punës në fuqi.

3. Në rastin e depozitë në një monedhë të ndryshme nga monedha e të ardhurave, ekziston rreziku që lidhet me luhatjen e normave të interesit.

### Kushtet kryesore ekonomike

Lista e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të produktit:

#### Normat e Interesit

Per EUR(%)

	NI:
≤ 24,999.00	0.07%
25,000.00- 49,999.00	0.10%

50,000.00- 99,999.00	0.10%
Mbi 100.000 e negociueshme Per GBP(%)	
NI:	
≤ 49,999.00	0.20%
Mbi 50.000 e negociueshme Per LEK(%)	
NI:	
≤ 2,499,999.00	1.75%
2,500,000.00- 4,999,999.00	1.80%
5,000,000.00- 9,999,999.00	1.90%
Mbi 10.000.000 e negociueshme Per USD(%)	
NI:	
≤ 99,999.00	0.20%
Mbi 100.000 e negociueshme	
<b>Tatim i mbajtur në burim</b>	
Tatimi në burim aplikohet sipas ligjit shqiptar i pagueshëm në momentin e përfitimit të interesit	15% e interesit të përfituar
<b>Komision rinovimi i Depozitës me Afat</b>	
	0.3 USD 50 LEK 0.3 GBP 0.3 EUR
<b>Komision Mirëmbajtje</b>	
Komisioni i mirëmbajtjes së llogarisë* ALL/EUR/USD/GBP <i>*Të lutem referoju pikës 2 në seksionin e "Rreziqet e Depozitës me Afat"</i>	Falas
<b>Kosto të tjera të lidhura me depozitën</b>	
Lëvizjet e Aktivitetit të Depozitës	Falas
Rritja e shumës së depozitës	Falas (e aplikueshme vetëm në datën e maturimit)
Ulja e shumës së depozitës	Falas (e aplikueshme vetëm në datën e maturimit)
Lëshimi i konfirmimit bankar	1000 Lek (Opsionale, sipas kërkesës së klientit)
<b>Likuidimi i interesit</b>	
Shuma	300,000.00 LEK
Interesi Bruto	5,178.08 LEK
Taksa	776.71 LEK
Interesi Neto	4,401.37 LEK
Periodiciteti i interesit dhe pagesës së taksave	Një Vjeçar
Data e likuidimit të interesit	23/12/2016

## Tërheqja para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat

### Tërheqja nga Kontrata

Nëse depozituesi do të kërkojë përpara datës së maturitetit pagesën e pjeshme ose të plotë të shumës që ka investuar në depozitë, dhe nëse Banka, sipas diskrecionit dhe gjykimit të saj, do të pranojë kërkesën për tërheqje të shumës së investuar në depozitë, atëherë Depozituesi nuk do të përfitojë vlerën e interesit të përlogaritur deri në atë moment. Shuma

e interesit të përlogaritur deri në momentin e zgjidhjes së kontratës do të jetë penalteti që do të mbahet për shkak të mosrespektimit të detyrimeve kontraktore në lidhje me afatin e kontratës nga ana e Depozituesit.

#### **Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore**

Çdo ndryshim i kushteve, i cili përcaktohet në mënyrë të shprehur në kontratën e depozitës, do të jetë efektiv pas dakordësisë me shkrim të palëve. Asnjë ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në kontratën e depozitës nuk do të jetë efektiv nëse nuk janë dakordësuar me shkrim midis palëve.

#### **Ankesat**

*Ankesat do të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:*

- Në formë shkresore përmes postës zyrtare të bankës;
- Në "Kutinë e ankesave & sugjerimeve" që ndodhet në degë (Ju dëgjojmë 100%);
- Ankesa me shkrim të cilat dërgohen nëpërmjet faqes të internetit të bankës në adresën zyrtare të email-it: [complain@intesasanpaolobank.al](mailto:complain@intesasanpaolobank.al)
- Në Qendrën e Kontaktit : 08006000

*Koha e kthimit të përgjigjes nga ana e Bankës është maksimumi brenda 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.*

## **Fjalorthi i Termave Kryesore**

---

**ASD-** Agjencia e Sigurimit të Depozitave (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, e cila ushtron funksionet e saj, me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014, "Për Sigurimin e Depozitave".

**Interesi Neto-** vlera bruto e interesit minus tatimin në burim

**Tatimi ne burim** është një kërkesë e qeverisë për pagesin për një të ardhur të tatueshme në burim ose tatimin e zbritshëm nga pagesa në favor të qeverisë .Ky tatim aplikohet më së shumti në të ardhurat nga puna , pagesa interesash ose dividendë.

**Penalitet-** Vlera e interesit e gjeneruar por jo e përfituar prej klientit